



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Data: 19 Maj 2017

DEMANT

Në lidhje me keqpërdorimin e Apelit për ndihmë të Amelës 4 vjeçare nga f. Pallaticë

Fondi për sigurim shëndetësor i Maqedonisë kategorikisht demanton lajmin e postuar në web portalin top-news.mk dhe portalet tjera që e kanë kopjuar lajmin me titull 'Amela 4 vjeçe e sëmur nga Tetova që përloti gjithë shqiptarët: Dua të jetoj, më ndihmoni!'

Fondi për sigurim shëndetësor i Maqedonisë i informon të gjithë ushtruesit e detyrës gazetar dhe lexuesit e portaleve se në evidencën historike të Fondit, nuk egziston Kërkesë për mjekim jashta shtetit në emër të të siguarës Amela Iseni ose në ndonjë emër të anëtarëve të familjes Iseni.

Pas kontaktit telefonik të sotshëm mes kabinetit të Fondit dhe prindit të Amelës, u qartësua realiteti i rastit të Amelës. Prindi i Amelës I.I., u prononcua se teksti që qarkullon nëpër portalet shqipe është i keqinterpretuar nga gazetarët, duke e shtrembëruar realitetin e Apelit për ndihmë.

Për të qenë më korekt ndaj këtij rasti, është e vërtetë e familja Iseni ka kontaktuar me personat e autorizuar të Fondit për zgjidhjen e situatës së vështirë shëndetësore të Amelës, tanimë 4 vjeçare, por në kohën kur drejtori gjeneral i tanishëm, Orhan Ramadani nuk ka qenë i emëruar për ta ushtruar detyrën si drejtor gjeneral i Fondit për sigurim shëndetësor të Maqedonisë.

Ju informojmë se Fondi për sigurim shëndetësor i Maqedonisë mundëson të gjitha barnat e listës pozitive të merren me recetë nga ana e të siguarave ose refundimin e të njejtave në procedurë të paraparë me Ligj.

Fondi për sigurim shëndetësor i Republikës së Maqedonisë në çdo kohë është i gatshëm të ndihmojë të siguarit në realizimin e të drejtave të tyre që rrjedhin nga Ligji për sigurim shëndetësor.